



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), nenin 65.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.07.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Radovan Denič**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Novobërdë, nga subjekti politik "SRPSKA Lista" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Predrag Stojkovič.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Radovan Denič dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 29.06.2021, Nr.1701/2021, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Predrag Stojkovič, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye të zgjedhjes në pozitë të nëpunësit civil, në administratën komuna të Novobërdës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirenditur është, z.Radovan Denič, i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.07.2021

Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

